REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr/Br. 280/20
Datë/Datum 18.05.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Shefkinaze Vllasaliu	**12.05.2020**	**18.05.2020**	**280-20**
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	Nr. i lëndës:

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën 07.05.2020, Tenderuesi ankues, Grup i OE: "Companya Eskavatori" Sh.p.k.& KNPSH. "PAPENBURG & ADRIANI COMPANY" Sh.p.k. & "Best Company" SH.P.K. Magjis. Ferizaj – Prishtinë, Ferizaj, ka parashtruar ankesë me nr: 280-20,

kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES (24.04.2020), ku është rekomanduar për kontratë Tenderuesin "GËRLICA - COMPANY" SH. P.K., Babush P.N., FERIZAJË, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Asfaltimi i rruges Pleshine-Kashtanjeve te Ferizajt-projekt tre vjeçar" me nr. të prokurimit: 656-17-3827-511, dhe numër të brendshëm : 656-17-115-511, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA FERIZAJ.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: **4,000,000.00 €**, *(100,000.00 për vitin 2017, 300,000.00, për vitin 2018, 3,600,000.00 për vitin 2019).*

Lidhur me këtë lëndë, është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së, :
Vendimi, PSH. 483-485-17 me datë 03.01.2018 dhe
Vendimi, PSH. 261/19, 263/19 dhe 280/19 me datë 03.07.2019.
Vendimi, PSH. 769/19, 778/19 dhe 792/19 me datë 23.12.2019

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Tenderuesi ankues, Grup i OE: **"Companya Eskavatori"** Sh.p.k.& KNPSH. **"PAPENBURG & ADRIANI COMPANY"** Sh.p.k. & **"Best Company"** SH.P.K. Magjis. Ferizaj – Prishtinë, Ferizaj, pretendon se AK, ka bërë shkelje te dispozitave të *Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (më tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së dhe atë konkretisht*:

Neni 7, *Barazia në trajtim/Jo diskriminimi*

Neni 13, *Neni 13 Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik*

ANKESË

Aktiviteti i Prokurimit:
Asfaltimi i rruges Pleshine-Kashtanjeve te Ferizajt-projekt tre vjeqar
Nr. I Prokurimit: 656-17-3827-5-1-1
Nr. I Brendshëm: 656-17-115-511
Në lidhje me Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 24.04.2020 dhe letrës standarde për tenderuesin e pasuksesshëm të datës 24.04.2020.

Më datë 24.04.2020 kompania jonë përmes platformës elektronike të prokurimit ka pranuar Njoftimin Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues në lidhje me projektin në fjalë, ku në këtë njoftim AK Komuna Ferizaj shpërblen me kontratë OE Gerlica Company. Po ashtu më 24.04.2020 kemi pranuar letren stadarde për tenderuesin e pasuksesshëm.

Me date 17.10.2019 AK Komuna Ferizaj kishte shpallur fitues për këtë projekt OE Gerlica Company, kunder ketij vendimi konzorciumi jonë me të drejtë ligjore më 06.11.2019 kishte parashtruar ankese pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

Pas shqyrtimit të ankesës sonë nga OSHP më datë 23.12.2019 kemi pranuar vendimin e panelit shqyrtues me numër 778/19 per ankesen e parashtruar. Në këtë vendim ankesa jonë aprovohet si e BAZUAR dhe anulohet vendimi në fjalë dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM.

Duke u bazuar në vendimin e OSHP të ankeses me numer 778/19 është e pakjartë se si është e mundur që edhe pas kthimit në rivlerësim nga OSHP AK Komuna Ferizaj prap padrejtësisht shpall fitues një operator ekonomik i cili nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit në fjalë dhe është i pa përgjegjshëm kjo vërtetohet edhe ne raportin e ekspertit shqyrtues ku ceket se dokumentet-diploma e dorëzuar nga OE i shpallur fitues është në kundërshtim me LPP-në.

OE i shpallur fitues nuk plotëson kërkesat mbi mundësite teknike dhe/ose profesionale pasi që për kërkesën për gjeodetin e licensuar ka ofruar diplomën universitare në gjuhë Maqedone, të z. Zekirja Elezi, e cila bie në kundërshtim me nenin 13 paragrafi 4 të ligjit të prokurimit publik në fuqi, ku shume kjart definohet se dokumentet tenderuese duhet të dorëzohen në gjuhën Shqipe, Serbe ose Angleze.

Po ashtu diploma për gjeodetin është diplomë universitare e fituar jashtë shtetit të Kosovës por për diplomën në fjalë mungon nostrifikimi i diplomës dhe si e tillë, pa nostrifikim, ajo është e pa vlefshme.

Me favorizimin e OE fitues duke e shperblyer me kontratë edhe pse nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë shkelet neni 7 i ligjit të prokurimit publik në fuqi.

Po ashtu vlen të theksohet se AK në njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues shpall fitues OE Gerlica Company por pas qasjes në dokumentacionin tenderues kemi vërejtur se kompania konkuron në konzorcium me kompaninë KAG Aspahlt Company, e cila nuk figuron fare ne njoftimin mbi vendimin e AK.

Si pasojë e shkeljeve të lartëpërmendura konzorciumi jonë propozon që:

TË APROVOHET si e bazuar ankesa jonë kundër vendimit të datës 24.04.2020.
Dhe të ANULOHET vendimi i datës 24.04.2020 të tenderit: Asfaltimi i rruges Pleshine-Kashtanjeve te Ferizajt-projekt tre vjeqar me nr. Të prokurimit: 656-17-3827-5-1-1dhe lënda të kthehet në RIVLERSIM.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë të njëjta me ato të parashtruara në Kërkesën për Rishqyrtim.

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjn me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore).

Tenderuesi ankues, Grup i OE: **"Companya Eskavatori"** Sh.p.k.& KNPSH. **"PAPENBURG & ADRIANI COMPANY"** Sh.p.k. & **"Best Company"** SH.P.K. Magjis. Ferizaj – Prishtinë, Ferizaj, pretendon se AK, ka bërë shkelje te dispozitave të LPP te:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.Stafi profesional:
b.Një gjeodet te licencum

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
b. Një gjeodet, të argumentuar me licence valide. Licenca dhe diploma duhet te ofrohen kopje te vërtetuara.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues /ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me aftësinë teknike dhe / ose profesionale:

OE "2A Group"SH.P.K dhe 2T SHPK sipas vendimit te OSHP-se komisioni i vleresimit eshte obliguar qe OE nefjale ti kerkohet sqarime per referencat,komisioni i vleresimit ka kerkuar nga ky oe qe te sjelle referenca duke specifikuar vleren per periudhen tri vjeçare mirepo i njejti nuk ka sjelle referencat sipas DT-se dhe kerkeses se dt 06.04.2020, si dhe te i njejti nuk ka ofruar kontraten e punes te vazhduar per ingjinierin e ndertimtarise ashtu siq eshte kerkuar ne shkresen e dt.06.04.2020. Gjithashtu deklarata per vazhdimin e validitetit te marreveshjes se konzorciumit OE ne fjale nuk ka sjelle asnje dokument.

DEKLARATË

[të deklarohet komisioni vlerësues mbi arsyet që e mbështesin këtë rekomandim]

Komisioni pas vlersimit te ofertave rekomandon dhenjen e kontratës Operatorit Ekonomik " GËRLICA - COMPANY" si Operator Ekonomik teknikisht i pergjegjeshem me çmimë me të lirë

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

Tenderuesi ankues, Grup i OE: "**Companya Eskavatori**" Sh.p.k.& KNPSH. "**PAPENBURG & ADRIANI COMPANY**" Sh.p.k. & "**Best Company**" SH.P.K. Magjis. Ferizaj – Prishtinë, Ferizaj, *është palë me interes sipas nenit 4.1.26* nga rezultati i këtij aktivitetit të prokurimit të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA FERIZAJ, në raport me këtë kontratë që mund të jetë në rrezik të dëmtimit material nga një shkelje e pretenduar.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).

Lidhur me këtë aktivitet të Prokurimit OSHP ka pruar tri (3) vendime si vijon:

1. PSH. 483-485-17 me datë 03.01.2018

1. PANELI SHQYRTUES, i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të LPP-së, ka vendosur me datë 03.01.2018, sipas ankesave të parashtruara nga dy tenderues:

1. Grup i OE: "**Companya Eskavatori**" Sh.p.k.& KNPSH. "**PAPENBURG & ADRIANI COMPANY**" Sh.p.k. & "**Best Company**" SH.P.K. Magjis. Ferizaj – Prishtinë, Ferizaj dhe
2. "GËRLICA - COMPANY" SH. P.K., Babush P.N., Ferizaj.

kundër vendimit të AK-së - Njoftim për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Asfaltimi i rruges Pleshine-Kashtanjeve te Ferizajt-projekt tre vjeçar" me nr. të prokurimit: 656-17-3827-511, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA FERIZAJ, më datën 03.01.2019, ka prua:

VENDIM

I. **APROVOHEN** si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik "KNPSH"Papenburg & Adriani Company & Eskavatori & Best Company"shpk - Ferizaj, dhe OE "Gërlica Company", nga Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Asfaltimi i rrugës Pleshinë — Kashtanjevë të Ferizajit — projekt tre vjeçar, me nr. prok: 656/17/3827/511", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) / Komuna Ferizaj.

II. **ANULOHET** njoftimi për dhënie të kontratës i AK -së /Komuna Ferizaj/, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull: Asfaltimi i rrugës Pleshinë — Kashtanjevë të Ferizajit — projekt tre vjecar, me nr. prok: 656/17/3827/511" dhe lënda kthehet në Ri-vlerësim.

2. PSH. 261/19, 263/19 dhe 280/19 me datë 03.07.2019

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z. Blerim Dina– Kryetar, z. Nuhi Paçarizi- Referues, z. Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Konz KNPSH Papenburger&Adriani Company & Eskavatori&Best Company shpk", OE-"Konz NTP Begisholli & Conex Group" dhe OE-"Gërlica Company"shpk kundër vendimit te autoriteti kontraktues për anulimin e aktivitetit te prokurimit me titull:"Asfaltimi i rrugës Pleshinë–Kashtanjevë- Projekt tre vjeçar" me numër të prokurimit:656/17/3827/511iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)"Komuna Ferizaj"më datën 25.06.2019 mori këtë:

VENDIM

I.<u>APROVOHET</u>, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik:"Konz KNPSH Papenburge r&Adriani Company & Eskavatori & Best Company shpk", ankesa e OE-Konz NTP "Begisholli & Conex Group" dhe ankesa e OE-"Gërlica Company"shpk, kundër vendimit te autoriteti kontraktues për anulimin e aktivitetit te prokurimit me titull "Asfaltimi i rrugës Pleshinë–Kashtanjevë- Projekt tre vjeçar" me numër të prokurimit:656/17/3827/511 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues AK- Komuna Ferizaj.

II.<u>ANULOHET</u>,vendimi i autoriteti kontraktues për anulimin e aktivitetit te prokurimit me titull"Asfaltimi i rrugës Pleshinë–Kashtanjevë- Projekt tre vjeçar" me numër të prokurimit:656/17/3827/511 AK-"Komuna Ferizaj" dhe lënda kthehet në Ri vlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

3. PSH. 769/19, 778/19 dhe 792/19 me datë 23.12.2019:

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-se, ne baze te nenit 105 dhe nenit 106 te Ligjit për Prokurim Publik te Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ne përbërje te: z. Blerim Dina- Kryetar, z. Nuhi Paçarizi- Referues, z. Goran Milekovic anëtar, duke vendosur sipas ankesës se parashtruar nga grupi i operatoreve ekonomik: OE "2A Group & 2T Shpk"-Prishtine dhe ankesës se grupit te OE: "Konzorciumi KNPSH "PAPENBURG & ADRIANI COMAPNY Sh.p.k & Companya ESKAVATORI Sh.p.k & Best Company Sh.p.k-Ferizaj si dhe ankesës se OE: "N.P.T.BEGISHOLLI

& CONEX GROUP", kundër njoftimit për dhënie te kontratës, ku është rekomanduar për kontrate operatori ekonomik: OE"GERLICA-COMPANY", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Asfaltimi i rrugës Pleshine-Kashtanjeve te Ferizajit-projekt 3 vjeçar", me numër të prok:656-17-3827-5-1-1,inicivar nga Autoriteti Kontraktues/A1g, Kuvendi Komunal Ferizaj, më date:26.11.2019, mori këtë:

VENDIM

I. **APROVOHEN** si pjesërisht te bazuara ankesat e:grupit te operatoreve ekonomik"2A Group & 2T Shpk"- Prishtine dhe e grupit te OE"Konzorciumi KNPSH "PAPENBURG & ADRIANI COMAPNY Sh.p.k &Company ESKAVATORI Sh.p.k &Best Company Sh.p.k-Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Asfaltimi i mugës Pleshine-Kashtanjevë te Ferizajt-projekt 3 vjeçar", me numër te prok:656-17-3827- 5-1-1,inicivar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Kuvendi Komunal Ferizaj.

II. **HEDHET POSHTE SI E PALEJUAR**, ankesa e grupit te operatoreve ekonomik OE: "N.P.T.BEGISHOLLI & CONEX GROUP",lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Asfaltimi i rrugës Pleshinë-Kashtanjevë te Ferizajt-projekt 3 vjeçar numër te prok:656-17-3827-5-I-1,inicivar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Kuvendi Komunal Ferizaj, si pale pa interes sipas nenit 111 paragrafi I.5-1.8, përkitazi me nenin 4 paragrafi 1.26 te LPP-se.

III. **ANULOHET**, njoftimi për dhënie to kontratës lidhur me aktivitetin to prokurimit me titull: "Asfaltimi i rrugës Pleshinë-Kashtanjevë to Ferizajt-projekt 3 vjeçar", me numër të prok:656-17-3827-5-I-1,inicivar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Kuvendi Komunal Ferizaj, dhe lënda kthehet ne **Rivleresim.**

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Tenderuesi ankues, Grup i OE: **"Companya Eskavatori"** Sh.p.k.& KNPSH. **"PAPENBURG & ADRIANI COMPANY"** Sh.p.k. & **"Best Company"** SH.P.K. Magjis. Ferizaj – Prishtinë, Ferizaj, deklaron se Nuk pajtohet me Njoftimin mbi vendimin e publikuar nga AK- KOMUNA FERIZAJ të datë 24.04.2020. dhe PRETENDON se AK ka bërë gabim gjate vlerësimit të tenderit.

Dispozitat e shkelura të LPP-së, sipas tenderuesit ankues, nga ana e Autoriteti Kontraktues, janë:

Neni 7, *Barazia në trajtim/jo diskriminimi*

Neni 13, *Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik*

Eksperti shqyrtues pas ekzaminimit të tenderit dhe rrjedhës së procedurës së vlerësimit dhe pretendimeve të palës ankuese në ankesë, duke u bazuar ne shkresat e lendes se trajtuar sqaron me sa vijon:

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur *(Neni 7)*

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, (**Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**) **është i pabazuar**, sepse me rastin e kontrollimit të Dosjes së tenderit, Njoftimit për Kontratë dhe dokumentacionin të dorëzuar me tender, gjatë procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues e ka shpallur fitues tenderuesin e përgjegjshëm, që është në pajtim me Nenin 60 të LPP,

Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar:
1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Autoriteti Kontraktues me rastin e shpalljes së Tenderuesit "GËRLICA - COMPANY" SH. P.K., Babush P.N., Ferizaj, fitues për këtë kontratë nuk ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP- së, nuk ka bërë kurrfarë favorizimi të ofertës së këtij operatori i cili sipas vlerësimit nga ana ime **është i përgjegjshëm dhe nuk ka diskriminuar** operatoret tjerë pjesëmarrës në tender e në këtë rast as Tenderuesi ankues, Grup i OE: **"Companya Eskavatori"** Sh.p.k.& KNPSH. **"PAPENBURG & ADRIANI COMPANY"** Sh.p.k. & **"Best Company"** SH.P.K. Magjis. Ferizaj – Prishtinë, Ferizaj, i cili e ka ofertën më të lartë për 749,512.30 €.

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur *(Neni 13- Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik)*

Eksperti shqyrtues, konstaton se pretendim i tenderuesit ankues, se janë bërë shkelje të Nenit 13 të LPP-së, **është i pabazuar**, sepse duke u bazuar në dokumentacionin e prezantuar që kam shqyrtuar, Autoriteti Kontraktues **e ka bërë** Ekzaminimin, Vlerësimin e Tenderit, në pajtim me neni 59 par. 4 të LPP-së, po citoj:
"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".
Tenderuesi ankues, pretendon se tenderuesi i shpallur fitues nuk i ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Neni 9.1. & 9.2 nga Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD), faqe 12-13 të DT:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

Kapaciteti teknik dhe profesional:

2. Stafi profesional:
b. Një gjeodet te licencum

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
b. Një gjeodet, të argumentuar me licence valide. Licenca dhe diploma duhet te ofrohen kopje te
vërtetuara.

Eksperti shqyrtues në bazë të dokumentacionin të dorëzuar me ofertë-tender ka konstatuar, se nuk qëndron pretendimi i tenderuesit ankues, se autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të tenderit të fituesit "GËRLICA - COMPANY" SH. P.K., Babush P.N., Ferizaj, pa të drejtë e ka shpallë të përgjegjshëm te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, pasi që për gjeodetin e licensuar ka ofruar diplomën universitare në gjuhë Maqedonase, të z. Zekirja Elezi.
Autoriteti Kontraktues me qëllim të respektimit të Vendimit të OSHP – së me numër: PSH. 769/19, 778/19 dhe 792/19 me datë 23.12.2019 dhe *bazuar në nenin 59 pika 4 dhe 72 të LPP-ës pika* 2, me rastin e Rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka kërkuar sqarime plotësuese nga tenderuesi "GËRLICA - COMPANY" SH. P.K., Babush P.N., Ferizaj, për gjeodetin e licensuar të z. Zekirja Elezi , përkthimin e diplomës së dorëzuar universitare në gjuhë Maqedonase, në një nga gjuhët zyrtare (në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze.

Lidhur me rastin e paraqitur në këtë tender, AK me datë 04.01.2020 ka marrë interpretim nga KRPP-ja, Po i njejti interpretim Ligjor edhe nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik te INFORMACIONE / PYETJE TË SHPESHTA, lidhur me këto raste (*pyetja dhe përgjigjja 66*) në mes tjerash ka dhënë opinionin si vijon:

Për veç tenderi, i cili ofron specifikimet teknike në gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me LPP, duhet të përjashtohet, ndërsa për cilindo dokument tjetër të kërkuar si dëshmi sipas nenit 65-71 të LPP-së, në përputhje me nenin 72 të LPP-së mund të kërkohet nga OE që të dorëzojë një përkthim zyrtar të të njëjtit dokument. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderit dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Meqenëse tenderuesi i rekomanduar për kontrate "GËRLICA - COMPANY" SH. P.K., Babush P.N., Ferizaj, në lidhje me këtë çështje, me dt. 26.11.2019 ka dorëzuar ne OSHP, një parashtrese si sqarim ne lidhje me ketë pretendim, ku kësaj parashtrese ja ka bashkangjitur diplomat) me përkthim origjinal te përkthyer nga përkthyesi gjyqësor z.Afrim Sejdini me dt. 05.06.2017, andaj, eksperti shqyrtues këto sqarime dhe dëshmi shtesë (*përkthimi i diplomës në gjuhën shqipe, licencen e vazhduar)* të cilat AK gjatë rivlerësimit i ka pranue nga tenderuesi i shpallur fitues , i kamë vertetue dhe janë pjesë e tenderit dhe shtojcë e këtijë raporti.
Pprandaj vlerësojë se AK nuk janë bërë shkelje të neni 13, sepse sqarimet dhe dëshmitë gjatë rivlerësimi janë bërë në pajtueshmëri me *nenin 59 pika 4 dhe 72 të LPP-ës pika* 2, për vlerësimin e *Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 69 i* LPP-së.

Ndërsa sa i përket pretendimit te OE ankues Konzorciumit KNPSH "PAPENBURG & ADRIANI COMAPNY Sh.p.k & Companya ESKAVATORI Sh.p.k &Best Company Sh.p.k-

Ferizaj, se diploma e gjeodetit te OE te rekomanduar për kontrate është e pa nostrifikuar, eksperti shqyrtues sqaron se nostrifikimi i diplomave nuk ka qenë kërkesë e FDT, prandaj sipas nenit 56.3 te LPP, operatoret ekonomik nuk mund te eliminohen për një kërkesë e cila nuk ka qene kërkesë e dosjes s tenderit dhe e njoftimit për kontrate, citojmë nenin 56.3 te LPP-së :

Tenderuesi, gjate procedurave te hapura, ose kandidati, gjate procedurave te kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do te diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla ne baza te ndonjë kërkesë ose kriteri qe nuk është i cekur ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit.

Pas këtyre argumenteve të prezantuara përmes këtij raporti, për pretendimet e Tenderuesi ankues, Grup i OE: "**Companya Eskavatori**" Sh.p.k.& KNPSH. "**PAPENBURG & ADRIANI COMPANY**" Sh.p.k. & "**Best Company**" SH.P.K. Magjis. Ferizaj – Prishtinë, Ferizaj, eksperti shqyrtues vlerëson se andaj AK me të drejtë dhe me arsye e ka kualifikuar të përgjegjshëm dhe e ka shpallur fitues tenderin e tenderuesit "GËRLICA - COMPANY" SH. P.K., Babush P.N., Ferizaj.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e Tenderuesit ankues **të refuzohet e pabazuar**, njëherësh propozoj që **të aprovohet Vendimi i Autoritetit Kontraktues** për dhënie të kontratës dhe të vazhdojë sipas dispozitave të LPP-së, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Asfaltimi i rrugës Pleshine-Kashtanjeve te Ferizajt-projekt tre vjeçar" me nr. të prokurimit: 656-17-3827-511, dhe numër të brendshëm : 656-17-115-511, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA FERIZAJ.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KOMUNA FERIZAJ.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues : – Grup i OE: "Companya Eskavatori" Sh.p.k.& KNPSH. "PAPENBURG & ADRIANI COMPANY" Sh.p.k. & "Best Company" SH.P.K. Magjis. Ferizaj – Prishtinë, Ferizaj.

РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
УНИВЕРЗИТЕТ „СВ. КИРИЛ И МЕТОДИЈ" - СКОПЈЕ
ГРАДЕЖЕН ФАКУЛТЕТ

ДИПЛОМА

РЕКТОРОТ НА УНИВЕРЗИТЕТОТ „СВ. КИРИЛ И МЕТОДИЈ" ВО СКОПЈЕ
И ДЕКАНОТ НА ГРАДЕЖНИОТ ФАКУЛТЕТ ВО СКОПЈЕ,
СО СВОИТЕ ПОТПИСИ И СО ПЕЧАТОТ НА УНИВЕРЗИТЕТОТ ПОТВРДУВААТ ДЕКА

Елези Рафиз Бекирја

РОДЕН-А НА 15.08.1963 ГОДИНА, ВО Т. Слатина Качаник-СР Југославија
НА ДЕН 15.04.1999 ГОДИНА ГО ЗАВРШИ ПОЛАГАЊЕТО НА ПРОПИШАНИТЕ ИСПИТИ
И СЕ ЗДОБИ СО ВИШЕ ОБРАЗОВАНИЕ (VI/1 СТЕПЕН) НА ГРАДЕЖЕН ФАКУЛТЕТ,
ПО ГЕОДЕЗИЈА И СТЕКНА ПРАВО НА СТРУЧЕН НАЗИВ

ГЕОДЕТСКИ ИНЖЕНЕР

ВРЗ ОСНОВА НА ТОА УНИВЕРЗИТЕТОТ „СВ. КИРИЛ И МЕТОДИЈ" ВО СКОПЈЕ МУ-Н ИЗДАВА
ДИПЛОМА ЗА ЗАВРШЕНО ВИШЕ ОБРАЗОВАНИЕ (VI/1 СТЕПЕН)
СО КОЈА КАНДИДАТОТ-КАТА ГИ СТЕКНУВА СИТЕ ПРАВА ШТО МУ-Н ПРИПАГААТ
СПОРЕД ЗАКОНИТЕ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

ВО СКОПЈЕ, 24 V 1999 ГОД. Г3-387 /VI

ДЕКАН
НА ГРАДЕЖНИОТ ФАКУЛТЕТ
Проф. м-р СТАНИСЛАВ МИЛОВАНОВИЌ

РЕКТОР
НА УНИВЕРЗИТЕТОТ
Проф. д-р АЛЕКСАНДАР ДИЧЕВСКИ

REPUBLIKA E KOSOVËS
NOTER
Mr.sc.Hebib V.Livoreka, Kaçanik

Akt en brevet
LRP.nr.4342/2017

Unë Mr.sc.Hebib V.Livoreka, noter në Zyrën Noteriale, në Kaçanik, rr."Ismajl Raka", pn.------
Vërtetoj se:kopja që i prinë tekstit, **"Diplomë",nr. 387, e dates 24 Maj 1999, e leshuar nga Universitet Kiril I Metodij, Shkup,** e bërë në zyrën time noteriale dhe pasi u bë krahasimi I përmbajtjes së sajë,në gjitha pikëpamjet, është konform (kopje identike) me **origjinalin** , që mu prezentua para meje e sjellur nga:----------
Arian Teneqja, i lindur ne Stagove,më date 02.04.1991 me vendbanim në Fsh.Stagove Kaçanik, identitetin e te cilit e konstatova ne baze numerit personal nr.1176315381, e leshuar nga MPB-ja e R.Kosoves, ----------
Dokumenti permban **nje faqe** dhe **nje flete**----------
Taksat për vërtetimin e kopjes së dokumentit origjinal, u caktuan duke u mbështetur në Udhzimin Administrativ nr.02/2012, mbi Tarifat e përkohëshme noteriale, në lartësi prej një 1 € një faqe, plus TVSH 18%, e cila eshte bere ne 10 egzemplar, pagesat noteriale 10 € (dhjete euro), plus 18% Tvsh-ja----------
Zyrja Noteriale në Kaçanik, më 18.08.2017,(tetembedhjet gusht dymije e shtatembedhjet)--

Noteri,
Mr.sc.Hebib V.Livoreka

REPUBLIKA E MAQEDONISË

UNIVERSITETI "SH.QIRILI DHE METODI" NË SHKUP
FAKULTETI I NDËRTIMTARISË

DIPLOMË

Rektori i Universitetit "Sh.Qirili dhe Metodi" në Shkup dhe Dekani i Fakultetit të Ndërtimtarisë në Shkup, me firmat e tyre dhe me vulën e Universitetit, vërtetojnë që

ELEZI Rafiz ZEKIRJA

e lindur me datë 15.08.1963 në Sllatinë, Kaçanik-, R.S.e Jugosllavisë, me datë 15.04.1999, ka dhënë të gjitha provimet e parapara dhe ka fituar arsimim të lartë (VI/I) në Fakultetin e ndërtimtarisë, në Gjeodezi dhe ka marrë titullin :

INXHINIER I NDËRTIMTARISË

Në bazë të kësaj Universiteti "Sh.Kirili dhe Metodi" në Shkup i lëshon këtë diplomë për kryerjen e studimeve, me të cilën kandidati fiton të gjitha të drejtat që i takojnë sipas Ligjit në Republikën e Maqedonisë.

Në Shkup, me datë 24.V.1999 Gz-387/VI.

DEKANI
Prof.M-r Stanisllav Millovanoviq
d.v.

V.V.

REKTORI
Prof.d-r- Aleksandar Ançevski
d.v.

Потврдуваме дека правилно го извршив преводот од македонски на албански јазик.
Гостивар, на ден: 5.6.2017 Судски преведувач: Африм СЕЈДИНИ
Vërtetoj se drejt e kreva përkthimin nga gjuha maqedonase në atë shqipe.
Gostivar, me datë: 5.6.2017 Përkthyes gjyqësor: Afrim SEJDINI
070 646 250

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova- Government of Kosovo
Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit/Ministrastvo Infrastrukture i Sredine/
Ministry of Infrastructure and Environment
Agjencia Kadastrale e Kosovës/ Kosovska Katastarska Agencija/ Kosovo Cadastral Agency

Në bazë të Ligjit për kadastër Nr. 04/L-013, UA Nr. 13/2019 dhe vendimit të komisionit për licencim nr:010-1-58/20, Agjencia Kadastrale e Kosovës lëshon këtë:
Na osnovu Zakona za katastar Br. 04/L-13 i AU Br. 13/2019 i odluke komisije za licenciranje br. 010-1-58/20 Kosovska Agencija za Katastar izdaje ovu:

LICENCË

Për kryerjen e shërbimeve kadastrale

për

GJEODETIN E LICENCUAR

ZEKIRJA ELEZI

Numri i licencës: 17

Data e dhënies së Licencës / Datum izdavanja Licence: 05.03.2020
Afati i skadimit të Licencës / Datum okončavanja Licence: 05.03.2025

Drejtor Ekzekutiv
Avni AHMETI

Kerkese per informata shtese

Prokurimi Ferizaj

Wed 4/22/2020 12:39

To: gerlica_company@hotmail.com; <gerlica_company@hotmail.com>;

I nderuar,

komisioni ka filluar me ri-vleresimin e projektit " Asfaltimi i rruges Pleshine- Kashtanjeve te Ferizajt- projekt tre vjeçare" me nr prok. 656-17-3827-5-1-1, per te vazhduar me ri-vleresimin na duhen keto informata shtese nga ju:

1. Te behet nje deklarate nen betim e cila tregon qe marreveshja e konzorciumit ne kete projekte eshte ende valide, te sillet e nenshkruar dhe e vulosur origjinale ne forme fizike si dhe ne forme te skenenuar ne email deri me se largu me 24.04.2020 ne ora 10:00!
2. Te sillet nje perkthim zyrtar i diplomes (nga gjuha maqedone ne gjuhen shqipe) te gjeodetit z. Zekirja Elezi si dhe te sillet licenca valide (pasi qe ika skaduar afati i licences me date 04.02.2020) e gjeoditet ne fjale dokemtenet te sillen me se largu deri me 24.04.2020 ne forme fizike si dhe te skenuara ne email deri ne ora 10:00!

Me respekt, zyra e Prokurimit- Ferizaj